



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER  
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Fier, më \_\_\_\_ .05 .2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale konsumi për Bankën e Gjakut ”**

- KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
**38434520-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: **1,397,673** (një milion e treqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre ) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,  
b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**  
Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Kriteri 2.2.1** Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se **559 000 lekë** (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedrat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar... ”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet **tatimore** brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Kriteri 2.3.1** Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **279 000 lekë**. (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk është më e madhe se 20% e vlerës së përlogaritur të kësaj kontrate).

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për permbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 55 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: [...]4. (b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

**Kriteri 2.3.2** Auto-deklarate për origjinën e mallit, ku të përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtësin e autorizimit për tregëtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pikë 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**Kriteri 2.3.3** Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) për lejimin e tregëtimit të mallrave të kërkuara në specifikimet teknike, të përkthyer dhe noterizuar. Në rast se OE është vet prodhues, duhet të paraqesë vetedeklarim me shkrim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77

të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 te VKM 285 datë 19.05.2021.

**Kriteri 2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

**Kriteri 2.3.5** Operoret ekonomike duhet te paraqesin nje vetedeklarim ku te deklarohet qe skadenca e mallrave do te jete sipas kushteve te percaktuara ne specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 ‘Kërkesat për kualifikim’, pika 1 e **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” ku parashikohet që:** *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Vendosja e këtij kriteri në formë deklarative është në përputhje me nenin 1 dhe 2 të e **Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”.***

**Kriteri 2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti te certifikates per tregetim të materialeve mjekësore ose ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e

tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

### Specifikimet Teknike:

#### Specifikime teknike

Nr	Emërtimi	Njësia
1	Karta plastike ABO/D per paciente	copë
2	Karta plastike ABO/D per dhuruesit	copë
3	Karta plastike Liss /Coombs	copë
4	Karta plastike ABO/ D per neonatet	copë
5	Karta plastike percaktimin e Du IgG	copë
6	Karta plastike e Rh phenotype	copë
7	Pool 2 qelizor	pako
8	Reagente qelizor A1,B	pako
9	Reagent per suspension te eritrociteve	pako

Specifikat për cdo material konsumi janë si më poshtë vijon:

#### **1. Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e RhD (në një kartë të vetme – për pacient).**

- Kartat duhet të përmbajne të pakten anti-A, anti-B dhe anti-DVI me baze monoklonale
- Kartat duhet të përmbajne edhe 2-mikrotubula neutrale për qelizat A<sub>1</sub> e B për metoden indirekte.
- Karta duhet të përmbaje 1 mikrotubul kontrolli me baze solucion buferik pa praninë e antitropave.
- Pamja e jashtme e kartave duhet të jetë transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucionet të shpërndara nëpër tubula dhe të mos ketë çarje ose demtime të tjera të fletës vulozuese të sigurisë.
- Reagentet qelizor A1 dhe B të jenë suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
- Pamja e jashtme: reagentet duhet të jetë pa turbullira, hemolizë apo precipitime.
- Skandanca duhet të jetë minimumi 6 muaj.

#### **2. Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt/indirekt) dhe përcaktimin e dyfishtë të RhD (në një kartë të vetme – për dhurues).**

- Kartat duhet të përmbajne të pakten **anti-A, anti-B, anti-DVI+/-** me baze monoklonale

- Kartat duhet te permbajne edhe 2-mikrotubula neutral per qelizat **A<sub>1</sub>** e **B** per metoden indirekte.
- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- Reagentet qelizor A1 dhe B te jene suspensione eritrocitar 0.8%, në flakone 10ml.
- Pamja e jashtme: reagentet duhet te jete pa turbullira, hemolize apo precipitime.
- Skandenca duhet të jetë minimumi 6 muaj.

### 3. Karta plastike me AHG-polispecifike (LISS/COOMBS).

- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t'u përdorur për:
  - ✓ Kontroll per antitruapat
  - ✓ Identifikim i antitrupave
  - ✓ Pajtueshmeri
  - ✓ Autokontroll
  - ✓ Test Coombs Direkt.
- Kartat duhet të jene mikrotubula me permbajtje AHG-polispecifike (me **anti- IgG** poliklonale me origjine shtazore dhe **anti-C3d** monoklonale).
- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- Skandenca duhet të jetë minimumi 6 muaj.

### 4. Karta plastike për përcaktimin e grupit të gjakut ABO (direkt) tek neonat dhe përcaktimin e RhD (ne nje karte te vetme)

- Kartat duhet te permbajne te pakten **anti-A**, **anti-B**, dhe **anti-DVI+** me baze monoklonale.
- Pamja e jashtme e kartave duhet te jete transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucioni te shperndara neper tubula dhe te mos kete carje ose demtime te tjera te fletes vulosese te sigurise.
- Skandenca duhet të jetë minimumi 6 muaj.

### 5. Karta plastike per përcaktimin e eDu IgG:

- Kartat duhet të jene të pershtatshme për t'u përdorur për:
  - ✓ Kontroll per antitrupa
  - ✓ Identifikim i antitrupave
  - ✓ Pajtueshmeri
  - ✓ Autokontroll
  - ✓ Test Coombs Direkt

- Karta duhet të përmbajë anti IgG poliklonale (me origjinë shtazore) në solucion buferik me forca jonike të ulët.
- Pamja e jashtme e kartave duhet të jetë transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucion të shpërndara nëpër tubula dhe të mos ketë çarje ose demtime të tjera të fletës vulozuese të sigurisë.

#### **6. Karta plastike për përcaktimin e antigjeneve të sistemit Rh dhe kell.**

- Kartat duhet të përmbajnë të paktën **anti-C, anti-E, anti-c, anti-e** dhe **anti -K** me baze monoklonale dhe origjinë humane.
- Pamja e jashtme e kartave duhet të jetë transparente, pa plasaritje/tharje, pa buleza ajri apo solucion të shpërndara nëpër tubula dhe të mos ketë çarje ose demtime të tjera të fletës vulozuese të sigurisë.
- Skandënca duhet të jetë minimumi 6 muaj.

#### **7. Pool qelizor për kontroll të antitropave të parregullt.**

- Pool-i qelizor për identifikimin e antitropave të parregullt të pacientit duhet të jetë me origjinë humane.
- Qelizat e përdorura në këtë pool preferohet të jenë nga dhurues unik/te vetem, grup O.
- Të kenë një përqendrim 0.8% ( $\pm 0.1\%$ ) e të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kartat plastike respektive.
- Pamja e jashtme duhet të jetë e pastër pa trubullime, pa hemolizë apo koagula.
- Lëvrimi duhet të jetë çdo muaj me nga një sasi.

#### **8. Reagent Qelizor A1,B për përcaktimin e grupit të gjakut (indirekt)**

- Reagentet qelizor A1 dhe B të jenë suspensione eritrocitare 0.8% ( $\pm 0.1\%$ ) në flakone minimalisht 10ml, të përshtatshme për t'u përdorur në kartat plastike respektive
- Pamja e jashtme duhet të jetë e pastër pa trubullime, pa hemolizë apo koagula.
- Lëvrimi duhet të jetë çdo muaj me nga një sasi.

#### **9. Reagent për përgatitjen e RBC**

- Reagent për përgatitjen e suspensioneve eritrocitare në flakone minimalisht 50 ml, të përshtatshme për t'u përdorur në kartat plastike respektive
- Pamja e jashtme duhet të jetë e pastër pa trubullime, pa hemolizë apo koagula.

Shënim : Të gjitha tipet e Kartave të përmendura më sipër duhet të jenë me xhel dhe levrimit duhet të bëhet 2 herë në vit ose më shpesh.

**Operatori ekonomik duhet të ofrojë në përdorim :**

1. Një inkubator i cili arrin dhe mban temperaturën 37 gradë celcius në mënyrë kostante. për inkubimin e kartave që të ketë interval të modifikueshëm te kohës sipas nevojave të laboratorit për testimet imunohematologjike
2. Centrifugë për kartat me xhel. e përshtatshme për centrifugimin e kartës për testim imunohematologjik. Me nje kapacitet jo me pak se 10 karta .
3. Të ofrojë mirëmbajtjen e pasijeve të mesipërme që do të jepen në përdorim për të gjitha rastet ku do të shfaqin probleme teknike.
4. Reader automatik (1 cope) i kartave. Kjo pajisje duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: o Të ofrojë mundësinë e paraqitjes në një monitor (të integruar ose pc) të rezultatit, mundësinë për ndërhyrje të mjekut në interpretim dhe mundësinë e printimit të rezultatit. o Të ofrojë pamje me resolution të lartë për një menaxhim sa më të sigurtë të rezultateve. o Të lexojë bar-code të mostrave të gjakut që do të testohen dhe të kartave mbi të cilat do të punohet.
5. Të sigurojë lidhjen me LIS. Operatori Ekonomik merr përsipër shpenzimet e lidhjes së pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe te ofroje mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.
6. Është e preferushme edhe një centrifugë për kartat me xhel për recovery.

Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “*b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë*” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “*për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*”

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar,*



dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet sipas DST-se.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike të mësipërme plotësojnë kushtin për materiale cilësore dhe janë përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **NJËSIA E PROKURIMIT:**